



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 23 QERSHOR 2022**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 23. JUNA 2022. GODINE**

**QERSHOR - JUN  
2022**

## **Rendi i ditës**

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.

## **Dnevni red**

1. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-143 o izmenama i dopunama Zakona br.08/L-066 o budžetskim izdvajanjima za Budžet Republike Kosova za 2022. god.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Po fillojmë seancën, kështu jemi marrë vesh në mbledhje të Kryesisë që fillimisht ta hapim një seancë për të cilën është pas vendosur edhe në seancën e mëhershme kur është trajtuar Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Po e trajtojmë pra pikën:

### **1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022**

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij bashkë me amendamentet e propozuara.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integrim Evropian e ka shqyrtuar projektligjin me amendamente dhe ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk rregullohen në mënyrë specifike nga Legjislacioni i Bashkimit Evropian.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve të Kthimit nuk e ka shqyrtuar projektligjin me amendamente në afatin e paraparë sipas Vendimit të Kuvendit të datës 14 qershor.

A e doni fjalën zoti kryetar i Komisionit për Buxhet, Armend Muja?

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Komisioni e ka trajtuar, përveç grupit punues ka pasur vetëm një amendamentim dhe të njëjtin pasi e ka miratuar ua ka rekomanduar edhe deputetëve të këtij Kuvendit që ta miratojnë.

KRYETARI: Janë këtu tri amendamente që janë propozuar për këtë projektligj.

Një është propozuar nga Komisioni Funkcional, kurse dy të tjera janë propozuar nga deputetja Ariana Musliu-Shoshi, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Kështu që i votojmë me rend.

Amendamenti 1.

Nga Komisioni Funkcional, pastaj kur t'i vijë radha deputetes ia japim fjalën.

Fillimisht e hedhim në votim amendamentin të cilin e ka propozuar Komisioni Funkcional, e votojmë këtë amendament.

Sa deputetë i kemi? 88 deputetë janë të pranishëm.

Kush është për amendamentin 1? Kush është kundër? Kush abstenon?

Ky amendament i ka marrë 62 vota, të nderuar deputetë, të gjitha votat janë për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Kështu që konsideroj që kalon amendamenti numër 1.

Amendamenti 2.

Është propozuar nga deputetja Ariana Musliu Shoshi,  
Ia japim fjalën deputetes për ta arsyetuar amendamentin.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, kryetar!

Të dy amendamentet të cilat i kam propozuar unë kanë ardhur si kërkesë direkte të shumë qytetarëve nga fshati Lubeniq, po ashtu e shumë qytetarëve apo banorëve të fshatit Klinë e Mesme të Skenderajt.

Kërkesa nga qytetarët e Lubeniqit është të pajisen me ujë të pijshëm, fatkeqësisht nuk kanë ujësjellës dhe nuk kanë ujë të pijshëm, e aty e dimë që ka shumë banorë të cilët jetojnë, po ashtu është një ndër fshatrat i cili ka pësuar shumë nga lufta dhe i cili nuk ka as edhe burra as djem, ka vetëm gra dhe vajza dhe nuk ka kush të përkujdeset për ta.

Prandaj, është shumë e rëndësishme që ata të pajisen me ujë të pijshëm.

Dhe, e dyta, ka të bëjë me rrugën në fshatin Klinë të Mesme, ka shumë banorë që jetojnë aty dhe siguria e tyre është e cenuar, pasi nuk kanë rrugë që të udhëtojnë, rruga e tyre nuk është e asfaltuar dhe është një ndër fshatrat të cilët kanë banorë dhe meritojmë që të kenë rrugë, pasi veç është edhe në projekte, mirëpo Komuna e Skenderajt nuk ka buxhet të mjaftueshëm që ta ndërtojë këtë rrugë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjala e ministrit lidhur me këtë amendament.

MINITRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Rishikimin që e keni para jush, pra e kemi nisur si rishikim të jashtëzakonshëm vetëm për një organizatë buxhetore. Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit e parasheh që për ato organizata që bëhet rishikimi të bëhen edhe konsultime dhe dëgjime buxhetore dhe në këtë rast konsultimet dhe dëgjimet buxhetore nuk janë bërë me asnjë organizatë tjetër, por vetëm me Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, sepse vetëm aty ka pasur ndryshim plotësim të buxhetit.

Sa i përket rishikimit të rregullt të mes vitit do ta keni shumë shpejt, ku po besoj pastaj do të mund të adresohen edhe projektet për organizata tjera buxhetore, siç janë projektet në këtë rast që u prezantuan nga deputetja Musliu-Shoshi. Faleminderit!

KRYETARI: E hedhim në votim amendamentin e dytë.

Amendamenti 2.

Kush është për këtë amendament?

Kush është kundër? Kush abstenon?

Na e sillni rezultatin, ju lutem!

Me 23 vota për, asnjë kundër, 44 abstenime, nuk kalon amendamenti i deputetes Musliu-Shoshi.

Edhe amendamentin e saj të tretë e hedhim në votim.

Amendamenti 3.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Me 22 vota për, 45 abstenime, asnjë votë kundër, nuk kalon amendamenti.

Tash e hedhim projektligjin në tërësinë e vet.

Të nderuar deputetë,

Po përgatitemi që të votojmë për projektligjin bashkë me amendamentin e miratuar.

Të nderuar deputetë,

Kush është për Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, bashkë me amendamentin e miratuar?

Kush është kundër? Kush abstenon?

Ky projektligj i mori 65 vota, të gjitha votat për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, kështu që konstatohet që Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.

*E përgatiti:*  
*Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*